



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:181461

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697192

KPPP.nr. 139/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Inspektorati i Tregut, me adresë në rr. “Arbënor e Astrit Dehari”, nr.21, Lagja e Spitalit, Prishtinë, kundër debitorit Operatori Ekonomik “Euro Goma” Sh.p.k., me numër të regjistrimit të biznesit 810323519 dhe me seli në Magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, Fshati Shkabaj, Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 184/2022 të datës 06.07.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Operatori Ekonomik “Euro Goma” Sh.p.k., ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 184/2022 i datës 06.07.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Eset Murati, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ministria e Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Inspektorati i Tregut, në bazë të dokumentit përbarues Aktvendim nr. 1937/19 i datës 29.03.2022 ka caktuar zbatimin e përbarimit përmes urdhrit përbarimor P.nr. 184/2022 të datës 06.07.2022 ndaj debitorit Euro Goma Sh.p.k., të cilin e ka detyruar që në emër të gjobës administrative t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,000.00 EUR (njëmijë euro), si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se me Aktvendimin Nr.ref.19/2022 të datës 29.03.2022 subjekti Euro Goma është gjobitur me gjobë në shumë prej 1,000.00 EUR, dhe se ndaj këtij Aktvendimi është parashtruar ankesë, ku pas shqyrtimit të kësaj ankese e njëjta është refuzuar dhe është lënë në fuqi aktvendimi i lartcekur. Krejt kjo për arsye se subjekti ekonomik Eurogoma Sh.p.k., ka vendosur për shitje produktin pa etiketë në gjuhën zyrtare, dhe se inspektorët e Inspektoratit të Tregut të MINT janë paraqitur në selinë e të njëjtit, me faktin se një konsumator kishte kërkuar reklamacion, dhe jo siç ceket në Aktvendim për inspektim të produkteve të shitjes lidhur me etiketa. Mirëpo debitori thekson se duke marrë parasysh se të gjitha produktet e kanë udhëzuesin, katalogun e tyre në raftet ku janë të ekspozuara, shitësi nuk është i obliguar që secilit mall t'i vendoset etiketa në gjuhën zyrtare. Andaj duke u nisur nga fakti se debitori ka vepruar në bazë të ligjit, gjykatës i propozon që ta aprovojë prapësimin e debitorit, ta anulojë Urdhrin Përmbarimor P.nr. 184/22 të datës 06.07.2022 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Eset Murati, si dhe ta obligoj kreditorin t'i paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se inspektorët e kanë inspektuar operatorin ekonomik Eurogoma Sh.p.k., në bazë të ankesës së konsumatorit për reklamacionin e një produkti dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar përmes procesverbalit se operatori në fjalë ka vendosur produkte për shitje pa etiketë në gjuhën zyrtare, dhe pretendimi i debitorit se nuk ka mundur që në secilën gomë të vendos etiketë, nuk qëndron pasi gomat nuk konsiderohen mall refuz. Ndërsa sa i përket njoftimit se debitori ka ushtruar padi, kreditori ka theksuar se ajo është procedurë e ndarë dhe se padia nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit dhe të lejohet zhvillimi i procedurës së përmbarimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Aktvendimin Nr. 1937/19 të datës 29.03.2022, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Aktvendimi Nr. 1937/19 i datës 29.03.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri*”, ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përmbartueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 01.07.2022.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 139/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.